

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-097/15**

**Prishtinë,  
22 Shkurt 2017**

Në çështjen juridike të:

**M. A. C.**

***Pala ankuese***

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Sylejman Nuredini, kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Beshir Islami, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/228/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA11728), të datës 13 mars 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 22 Shkurt 2017, mori këtë

## AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e M. A. C.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/228/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA11728), i datës 13 mars 2014.

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 11 korrik 2007, M. A. C. (në tekstin e mëtejshëm: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejshëm: AKP), ku kërkon ri-posedim të ngastrës kadastrale nr. 6746 (në tekstin e mëtejshëm: pronë e kërkuar).
2. Pala ankuese nuk e ka cekur datën kur ka ndodhur humbja e posedimit ndaj pronës së kërkuar dhe as nuk ka dhënë asnjë informacion lidhur me pronën e kërkuar përveç numrit të ngastrës kadastrale. Ai vetëm kishte theksuar se B.K. kishte blerë nga ai sipërfaqen prej 15 ari të pronës së kërkuar por se shfrytëzoi 16 ari, kështu, ai kërkon ri-posedimin ndaj 1 ari që nuk i ishte shitur atij.
3. Për të mbështetur kërkesën e tij, pala ankuese i kishte dorëzuar AKP-së dokumentet vijuese:
  - Kontratën e shitblerjes, të lidhur më 5 shkurt 1990 në mes të palës ankuese në cilësinë e shitësit dhe B. K. në cilësinë e blerësit. Objekt i shitjes ishte sipërfaqja prej 00.15.80 ha e ngastrës kadastrale nr. 6746, që ndodhet në vendin e quajtur “Pashallti”, e regjistruar në fletën poseduese nr. 8468.
  - Fletën poseduese nr. 8468 të lëshuar nga Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë i Komunës së Prizrenit më 14 dhjetor 1998, ku ceket ngastra kadastrale nr. 6746, (tokë e kultivuar e klasës së 2<sup>te</sup> me sipërfaqe të përgjithshme prej 00.48.27 ha, e ndodhur në vendin e quajtur “Pashalti”) në emër të palës ankuese.
  - Certifikatën nr. 36/1554, të lëshuar nga Komuna e Prizrenit më 13 nëntor 2008 me të cilën vërtetohet se M. A. C. dhe M. G. janë i njëjti person.

- Certifikatën mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme P-71813068-06746 të lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale e Prizrenit, të datës 18 nëntor 2008. Ngastra kadastrale nr. 6746 me sipërfaqe prej 00.48.27 ha, që ndodhet në vendin e quajtur “Pashalli” është e regjistruar në emër të palës ankuese.
4. Më 29 gusht 2008, Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kishte bërë identifikimin e pronës së kërkuar dhe konstatoi se ajo ishte e zënë nga B. K. (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në ankesë) i cili pretendoi të drejtën ligjore. Më 30 mars 2010 Sekretaria Ekzekutive e AKP-së vërtetoi se njoftimi i pronës së kërkuar ishte i saktë.
  5. Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së, me 21 prill 2009 kishte konstatuar se prona e kërkuar ishte e regjistruar në emër të palës ankuese sipas raportit të verifikimit.
  6. KKPK-ja me vendimin e vet KPCC/D/A/228/2014, të datës 13 mars 2014, kishte hedhur poshtë kërkesën për shkak të juridiksionit. KKPK-ja kishte konstatuar se lënda nuk kishte të bënte me konfliktin e armatosur të viteve 1998-1999.
  7. Vendimi i ishte dorëzuar palës ankuese më 9 tetor 2014 ndërsa palës përgjegjëse në ankesë më 22 gusht 2014. Pala ankuese kishte paraqitur ankesë më 16 tetor 2014 ndërsa pala përgjegjëse në ankesë nuk ishte përgjigjur.

#### **Pretendimet e palës ankuese**

8. Pala ankuese theksoi se vendimi i kundërshtuar përmban vërtetim të gabuar të gjendjes faktike.
9. Pala ankuese theksoi se në vend që ai të pranonte aktvendimin e arsyetuar, ai kishte pranuar vendimin e vërtetuar. Sipas tij vendimi ishte amatoresk, pasi që nuk përmbante arsyetimin se përse kërkesa e tij ishte hedhur poshtë si dhe atij nuk i ishin siguruar dokumentet e dorëzuara nga pala përgjegjëse në ankesë në mënyrë që ai të mund të jepte komentet e tij lidhur me to.
10. Në fund, pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme të shfuqizoj vendimin e KKPK-së dhe të kthej kërkesën në rishqyrtim sepse kërkesa e tij ishte e kompletuar; pala përgjegjëse në ankesë e kishte zënë pronën që nga data 27 shkurt 1998.
11. Ankesa i ishte dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë më 17 korrik 2015. Ai nuk ishte përgjigjur në ankesë.

**Arsyetimi ligjor**

12. Gjykata Supreme e shqyrtoi vendimin e kundërshtuar në përputhje me dispozitat e nenit 194 të LPK-së, dhe pas vlerësimit të deklarimeve ankimore konstatoi se
13. Ankesa është e pranueshme. Ajo ishte paraqitur brenda afatit 30 ditorë që parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me ligjin nr. 03/L-079.
14. Çështja që duhej konsideruar në këtë rast është nëse KKPK-ja kishte juridiksion për të shqyrtuar kërkesën e palës ankuese të paraqitur në AKP.
15. Për sa i përket pretendimit të palës ankuese se vendimi i KKPK-së ishte amatoresk, Gjykata Supreme konsideron se vendimi ishte i paqartë për palën ankuese. KKPK-ja ka lëshuar vendim të vërtetuar më 13 mars 2014. Vendimi posaçërisht i referohej paragrafit 18. Prandaj, Gjykata Supreme do të bëjë një përmbledhje të shkurtër të arsyeve se përse KKPK-ja nuk ka juridiksion në këtë lëndë.
16. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë për një urdhër të Komisionit për ririposimin e pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që dëshmon të drejtat e tij pronësore mbi pronën në fjalë por edhe e dëshmon që ai nuk është në gjendje të ushtroi të drejtat e tij mbi këtë pronë për shkak të rrethanave që drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999, apo rrethanave që rezultojnë nga ky konflikt.
17. KKPK-ja e kishte hedhur poshtë kërkesën mbi bazën se ai nuk kishte pasur juridiksion për të vendosur mbi meritat e kërkesës pasi që pala ankuese nuk e kishte dëshmuar se kërkesa e tij përfshinte rrethanat që drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me konfliktin e viteve 1998-1999 apo rezultojnë nga ai.
18. Së pari, Gjykata Supreme konstatoi se pala ankuese në shkallë të parë nuk e ka cekur datën e humbjes së posedimit mbi pronën e kërkuar.
19. Vetëm në fazën ankimore ai e kishte përmendur se ai e kishte humbur posedimin mbi pronën e kërkuar më 27 shkurt 1998.
20. Sipas nenit 12.11 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 *“Faktet e reja dhe dëshmitë materiale të paraqitura nga cilado palë lidhur me ankesën nuk pranohen dhe nuk shqyrtohen nga Gjykata Supreme përpos nëse tregohet se faktet dhe*

*dëshmitë e tilla me arsye nuk kanë mundur të jenë të njohura për palën në fjalë....”* Gjykata Supreme konstaton se nuk ka arsye që pala ankuese të mos përmend datën e humbjes së posedimit para AKP-së.

21. Së dyti, pala ankuese vet e pohoi se në vitin 1990 ai ia kishte shitur palës përgjegjëse në ankesë sipërfaqen prej 00.15.00 ha nga prona e kërkuar. Gjithashtu, ai kishte dorëzuar në Sekretarinë Ekzekutive të AKP-së kontratën e shitjes që tregon se ai kishte kryer transaksion të shitjes me palën përgjegjëse në ankesë në vitin 1990, domethënë para një kohe relativisht të gjatë para konfliktit.
22. Sidoqoftë, pretendimi i palës ankuese se pala përgjegjëse në ankesë shfrytëzon 1 ari të palës ankuese që nuk ka qenë subjekt i kontratës së shitjes, nuk është relevant në këtë procedurë. Pretendimet e palës ankuese nuk mund të shqyrtohen nga KKPK-ja apo Gjykata Supreme në këtë rast. Kontrata e pretenduar e shitjes, duke qenë se është e vitit 1990, tregon se kontesti në fjalë në mes të palëve nuk është drejtpërdrejtë i ndërlidhur me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë në vitet 1998/99 dhe as nuk rezulton nga ai. Ky është një fakt relevant që tani duhet të merret parasysh për sa i përket juridiksionit të KKPK-së.
23. Së treti, për sa i përket pretendimit të palës ankuese se atij nuk i janë siguruar dokumentet e dorëzuara nga pala përgjegjëse në ankesë në mënyrë që ai të mund të jap komentet e tij, Gjykata Supreme pohon se pala përgjegjëse në ankesë kishte qëndruar pasive gjatë procedurës në shkallë të parë dhe të dytë, kjo është arsyeja se përse palës ankuese nuk i është siguruar asnjë dokument i dorëzuar nga pala përgjegjëse në ankesë.
24. Duke marrë parasysh atë që u tha më lartë, vendimi i kundërshtuar i KKPK-së ishte lëshuar pas vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe mbi një bazë të tillë ishin zbatuar drejtë e drejta materiale dhe ajo procedurale.
25. Prandaj, Gjykata Supreme konstaton se KKPK-ja duke e hedhur poshtë kërkesën si kërkesë që bie jashtë juridiksionit të tij, ai ka marrë një vendim të drejtë. Rrjedhimisht, ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar.
26. Duke marrë parasysh atë që u tha më lartë, në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Ligjit 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.
27. Ky aktgjykim nuk e paragjykon të drejtën e palës ankuese për të kërkuar të drejtën e tij të pretenduar pranë gjykatës kompetente, nëse ai këtë e sheh të nevojshme.

**Këshillë juridike**

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, kryetar i Kolegjit**

**Krassimir Mazgalov, gjyqtar i EULEX-it**

**Beshir Islami, gjyqtar**

**Sandra Gudaityte, referente e EULEX-it**